



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
АКАДЕМИЈА ЗА СУДИИ И ЈАВНИ ОБВИНИТЕЛИ
ПАВЕЛ ШАТЕВ

KËSHILLIM ME TEMË:

**„Diskriminimi dhe shqetësimi në
vendin e punës (mobingu)“**

Shkup

04 mars 2024

Akademia për gjykatës dhe prokurorë publik

Pavel Shatev





РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
АКАДЕМИЈА ЗА СУДИИ И ЈАВНИ ОБВИНИТЕЛИ
ПАВЕЛ ШАТЕВ

GRUPI SYNUES I PJEŠMARRËSVE

Këshillimi është i dedikuar për nëpunësit gjyqësorë dhe prokurorë publikë nga të gjitha zonat e apelit, si dhe për nëpunësit nga Gjykata e Lartë e RMV-së, Gjykata e Lartë Administrative dhe Gjykata Administrative.

PASQYRË E SHKURTËR DHE OBJEKTIVAT E TRAJNIMIT

Trajnimi me temën “Diskriminimi dhe shqetësimi në vendin e punës (mobingu)” përfshin temat që dalin nga Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Ligji për Mbrojtjen nga Shqetësimet në Vendin e Punës, përkatësisht të drejtat që kanë të punësuarit sipas ligjeve të lartpërmendura.

Gjatë trajnimit do të bëhet dallimi ndërmjet Diskriminimit dhe Mobingut në vendin e punës, përkatësisht do të shpjegohet dallimi ndërmjet shqetësimit në bazë diskriminuese dhe shqetësimit psikologjik, gjegjësisht mobingut.

Trajnimi do të mbulojë konceptin dhe llojet e mobingut, kush mund të jetë kryerës i shqetësimit në vendin e punës, vendin dhe kohën e shqetësimit në vendin e punës, shqetësimin psikologjik dhe seksual gjatë punës, sjelljet dhe aktivitetet që nuk konsiderohen si shqetësim në vendin e punës, si dhe procedurën për mbrojtje nga shqetësimi në vendin e punës në kuadër të punëdhënësit dhe para gjykatës kompetente.

Gjithashtu, pjesëmarrësit do të njihen me afatet, me procedurën paraprake dhe zbatimin e procedurës së ndërmjetësimit dhe arritjen e marrëveshjes.

Trajnimi realizohet me qëllim të njohjes së nëpunësve gjyqësorë dhe të prokurorisë publike me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ligjit për Mbrojtjen nga Shqetësimi në Vendin e Punës, Ligjit për Marrëdhëniet e Punës, por edhe dispozitat e ligjeve të tjera pozitive që prekin këtë materie.

MATERIALI

- Prezantimet nga ligjëruesit

VENDI KU MBAHET TRAJNIMI

Akademia për gjykatës dhe prokurorë publik Pavel Shatev
Bul. „Jane Sandanski“ numër: 12
1000 Shkup





РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
АКАДЕМИЈА ЗА СУДИИ И ЈАВНИ ОБВИНИТЕЛИ
ПАВЕЛ ШАТЕВ

PERSONI I DETYRUAR PËR ORGANIZIMIN E TRAJNIMIT

Ivana Millanoviç, Akademia për gjykatës dhe prokurorë publik Pavel Shatev
Imejl-adresa: Ivana.Milanovik@jpacademy.gov.mk dhe tel. 02/2401-572

LIGJËRUESIT

m-r Lidija Tanevska Jadrovska, këshilltar i pavarur gjyqësor në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut

m-r Maja Ristova, avokat nga Zyra e Avokatisë Ristova

AXHENDA

04 mars 2024 (e hënë)

- | | | |
|-------------|--|---|
| 10:00-12:15 | Diskriminimi dhe shqetësimi në vendin e punës (mobingu) <ul style="list-style-type: none">Pyetje/diskutim | m-r Lidija Tanevska Jadrovska,
Gjykata Supreme e RMV-së |
| 12:15-12:30 | Pauzë | |
| 12:30-14:45 | Diskriminimi dhe shqetësimi në vendin e punës (mobingu) <ul style="list-style-type: none">Pyetje/diskutim | m-r Maja Ristova,
Zyra e Avokatisë Ristova |
| 14:45 | Plotësimi i një pyetëtori për vlerësimin e trajnimit | |



АСЈО
Академија за судии
и јавни обвинители